

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS**  
**BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**



**Programi mësimor**

# **GJUHË SHQIPE**

## **për klasën II**

**Shkup, 2021**

## TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

<b>Lënda mësimore</b>	Gjuhë shqipe
<b>Lloji/kategoria e lëndës mësimore</b>	E detyrueshme
<b>Klasa</b>	II (e dytë)
<b>Tema/fusha programore</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të dëgjuarit dhe të folurit</li> <li>2. Leximi dhe shkrimi fillestar</li> <li>3. Letërsi, të shprehurit dhe krijimtaria</li> <li>4. Njohuri mediatike dhe kulturë e medias</li> </ol>
<b>Numri i orëve</b>	5 orë në javë / 180 orë në vit
<b>Pajisjet dhe mjetet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• tablet, kompjuter, përforcues zëri. kufje;</li> <li>• tabelë e mençur;</li> <li>• lapustila (markera) shumëngjyrësh;</li> <li>• fletëza mësimore, plakate, afishe, ilustrime me figura (të ndara ose në varg) që kanë të bëjnë me përmbajtjet dhe veprimtaritë;</li> <li>• libra (me tregime të shkurtra, përrallëza, përralla, vjersha, gjëza, fjalë të urta)</li> <li>• revista për fëmijë, enciklopedi me ilustrime për fëmijët, fjalorë të ilustruar;</li> <li>• bibliotekë digjitale me libra;</li> <li>• bibliotekë me libra në klasë;</li> <li>• filma të animuar, regjistrime audio-vizuale shfaqjesh teatrale, softuerë mësimorë nga interneti dhe mjete të tjera audio-vizuale, si dhe mjete të tjera varësisht nga qëllimi mësimor.</li> </ul>
<b>Normativi për kuadrin mësimor</b>	<p>Punën edukativo-arsimore për klasën e dytë mund ta zhvillojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• profesori/arsimtari/mësuesi i mësimit klasor, VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS</li> <li>• pedagogu i diplomuar VII/1 ose VI/1 sipas KNK dhe 240 ECTS</li> </ul>

## NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënit që përmenden në programin mësimor shpjen në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën **Njohuri gjuhësore.**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
I-A.1	t'i shprehë dhe t'i transmetojë mendimet, ndjenjat, informacionin dhe qëndrimet e veta në situata të ndryshme komunikimi në gjuhën e vet amtare, nëpërmjet medimeve të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme;
I-A.4	të përdorë gjuhën standarde duke iu përmbajtur rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim;
I-A.6	të identifikojë veçoritë themelore të gjuhës amtare (alfabetin, historinë, dialektet etj.), si dhe ngjashmëritë e dallimet e saj me gjuhët e tjera;
I-A.8	të kuptojë përmbajtjen e mesazheve dëgjimore: të jetë në gjendje t'i shkëputë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë informacionet nga mesazhet dhe t'i shprehë ato (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.9	të kuptojë përmbajtjen e një teksti të shkruar: të jetë i aftë të veçojë, të analizojë, të vlerësojë dhe të përmbledhë informacionin nga teksti dhe ta shprehë atë (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.12	të shfrytëzojë informacione nga burime dhe medime të ndryshme dhe t'u qaset atyre në mënyrë kritike, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacioneve të paraqitura.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
I-B.1	nëpërmjet mësimin të gjuhës amtare zhvillohet identiteti i vet gjuhësor e kulturor, ndërsa nëpërmjet komunikimit gjuhësor përcillet trashëgimia kulturore dhe kultura e të jetuarit;
I-B.2	me përdorimin e gjuhës në kontekste të ndryshme dhe në forma të ndryshme mundësohet komunikimi dhe ndërveprimi efikas (gjithmonë duke pasur parasysh se me kë bëhet komunikimi);
I-B.4	përmbajtja dhe mënyra e shprehjes së mendimit personal mund të kontribuojë për të mbajtur e për të përmirësuar komunikimin, por edhe të shkaktojnë mosmarrëveshje e konflikte;

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të këtyre fushave të Standardeve nacionale: **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike dhe Të shprehurit artistik dhe kultura**

<i>Nxënësi /nxënësjja di dhe mund:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale;
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mësimi e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (feed back) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;
VI-A.3	t'i formulojë e t'i argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë me vëmendje e t'i analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe të sillet me respekt ndaj tyre, madje edhe atëherë kur nuk pajtohet me to;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo qoftë baze (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status shoqëror etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjytimeve të veta e të të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe

	vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore.
<i>Nxënësi /nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	njuhuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme – ato e bëjnë më të lehtë të nxënit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerret është me pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.

## REZULTATET E TË NXËNIT

Fusha programore: **TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT**

Gjithsej: **40 orë**

### Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të komunikojë në mënyrë verbale dhe joverbale në lidhje me përmbajtjen e dëgjuar të një teksti;
2. të marrë pjesë në bisedë duke shprehur mendimin e vet, duke pyetur të tjerët e duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre;
3. të tregojë e të përshkruajë sipas asaj që ka vënë re, që ka vëzhguar dhe nga përvoja;
4. të ritregojë e të tregojë duke i përdorur si duhet kohët e foljeve (të tashmen, të kryerën e thjeshtë dhe kohën e ardhme), si dhe ligjëratën e drejtë dhe ligjëratën e zhdrejtë.

Përmbajtjet (dhe konceptet):	Standardet për vlerësim:
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të dëgjuarit me të kuptuar të përmbajtjes</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përsërit (në mënyrë verbale dhe joverbale) tekstin që ka dëgjuar ose disa pjesë të tij.</li> <li>• Vepron sipas instruksionit që dëgjon (si udhëzim ose si porosi).</li> <li>• Identifikon numrin e folësve që e thonë tekstin që e dëgjon dhe i dallon folësit a janë fëmijë a të rritur, meshkuj a femra.</li> <li>• Identifikon personazhet që flasin në tekstin që dëgjon (a janë njerëz, kafshë ose bimë).</li> <li>• Identifikon personazhet në tekstin e dëgjuar dhe përcakton se kush (dhe kur) flet me zë të ulët, me zë mesatar ose me zë të lartë.</li> <li>• Identifikon numrin e fjalive që përmban teksti përderisa e dëgjon tekstin (më së shumti tri fjali).</li> <li>• Përshkruan vende, lokalitete, pamjen e sendeve dhe të personazheve sipas përmbajtjes së tekstit të dëgjuar.</li> <li>• Bën përmbledhjen (bën rezymenë) e përmbajtjes së tekstit të dëgjuar.</li> <li>• Identifikon dhe tregon të dhëna për kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e tjera të kryerjes së një veprimi ose për veçoritë e personazheve, sendeve dhe dukurive të përshkruara në tekstin e dëgjuar.</li> <li>• Identifikon gjërat e palogjikshme në tekstin e dëgjuar.</li> <li>• U përgjigjet llojeve të ndryshme të pyetjeve (pyetje të tipit <i>po/jo</i>, pyetje të tipit <i>kush/çfarë</i>, pyetje të tipit <i>ku/kur</i>) në lidhje me përmbajtjen që ka dëgjuar.</li> <li>• Parashtron lloje të ndryshme pyetjesh (pyetje të tipit <i>po/jo</i>, pyetje të tipit <i>kush/çfarë</i>, pyetje të tipit <i>ku/kur</i>) lidhur me përmbajtjen që ka dëgjuar.</li> <li>• Identifikon fjalë të panjohura në tekstin e dëgjuar.</li> <li>• Ndërton fjali me fjalët e reja që sapo ka mësuar.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të reaguarit pas dëgjimit të një teksti</b>  (komunikimi verbal dhe joverbal)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Reagon në mënyrë joverbale (nëpërmjet mimikës, gjesteve ose onomatopesë) në shenjë pajtimi / mospajtimi, besimi/mosbesimi, dyshimi, habie, pohimi / mohimi, talljeje ose zemërimi lidhur me përmbajtjen që ka dëgjuar.</li> <li>• Reagon me deklarata të shkurtra („Po. / Jo.“; "Mirë.“; "Sigurisht.“; "Dakord!"; "Vërtet?"; "Mendon?"; "Po si jo!") në shenjë pajtimi / mospajtimi, besimi/mosbesimi, dyshimi, habie, pohimi / mohimi, talljeje ose zemërimi lidhur me përmbajtjen që ka dëgjuar.</li> <li>• U përgjigjet gojarisht pyetjeve që dëgjon, duke zgjedhur një nga tri përgjigjet e ofruara, duke e plotësuar fjalinë me fjalë ose me përgjigjen <i>po / jo</i>.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Shqiptimi</b>  (i tingujve, i rrokjeve, i fjalëve dhe i fjalive)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqipton saktë tingujt e sistemit zanor të gjuhës standarde shqipe.</li> <li>• Përsërit fjalët e ndara në rrokje që i ka dëgjuar dhe në mënyrë të pavarur i ndan në rrokje fjalët e thjeshta (trerrokëshe dhe më së shumti katërrokëshe).</li> <li>• Njeh fjalët me tingujt që i mungojnë ose me tingujt e shtuar, me ndërtim ose me renditje të gabuar tingujsh dhe i thotë ato në mënyrë të drejtë.</li> <li>• Përcakton tingullin në fillim dhe në fund të fjalës.</li> <li>• Shqipton me intonacionin e duhur fjalitë dëftore, pyetëse e nxitëse, kur ato përdoren vetë dhe në kontekst me fjali të tjera.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Zhvillimi i bisedës</b>  (tema e bisedës, biseda, dialogu, folësi, bashkëbiseduesi)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• E fillon bisedën për një temë të caktuar (thotë atë që mendon dhe / ose parashton pyetje).</li> <li>• I bashkohet një bisede të filluar me një ose më shumë bashkëbisedues (shpreh pajtueshmëri / papajtueshmëri dhe / ose parashton pyetje / i përgjigjet pyetjes).</li> <li>• Komunikon në situata të ndryshme duke përdorur mënyrat e përcaktuara të përshëndetjes, të shkëmbimit të përshëndetjes, të njohjes, të prezantimit, të përshkrimit, të lutjes, të kërkimfaljes, të drejtimit dikujt etj.</li> <li>• Gjatë të folurit përdor lartësinë e duhur të tonit, në varësi me situatën e komunikimit dhe bashkëbiseduesin.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të ritreguarit, të treguarit dhe të përshkruarit me gojë</b>  (fjalitë dëftore, fjalitë pyetëse, fjalitë pohuese, fjalitë mohuese, ligjërata e drejtë, ligjërata e zhdrejtë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ritregon duke përdorur saktë fjalitë në kohën e kryer të thjeshtë (<i>Gjirafa e hëngri të gjithë ushqimin. Fëmijët dolën përjashta.</i>).</li> <li>• Ritregon me gojë për veprime të zakonshme, të përjetuara ose për veprime që do të ndodhin duke i përdorur si duhet fjalitë në kohën e tashme (Unë jetoj në qytet.), në kohën e kryer të thjeshtë (Postieri solli dy letra.) dhe në kohën e ardhme (Nesër do të shkoj në bibliotekë.).</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregon sipas asaj që ka vërejtur, që ka vëzhguar dhe nga përvoja.</li> <li>• Rrëfen një tregim të shkurtër duke u bazuar te një varg fotografish.</li> <li>• Rrëfen një tregim për një ndodhi/ngjarje (që ka dëgjuar a nga përvoja e vet), duke i paraqitur ato në mënyrë kronologjike dhe duke i përdorur ashtu si duhet kohët e foljeve.</li> <li>• Rrëfen rreth një teme të dhënë a një teme me zgjedhje, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm dhe format e drejta gramatikore.</li> <li>• Përshkruan njerëz, sende, bimë, kafshë dhe peizazhe duke u bazuar në atë që ka vëzhguar ose në imagjinatë.</li> <li>• Transmeton nëpërmjet ligjëratës së zhdrejtë një dialog të ndërtuar me dy fjali (dëftore, pyetëse, nxitëse, pohuese, mohuese) (- <i>Shqipe, ma jep librin, të lutem! - Prit t'i përfundoj detyrat, Leart! / Learti e luti Shqipen t'ia jepte librin. Shqipja i tha që të priste derisa t'i përfundonte detyrat.</i>);</li> <li>• Transmeton fjalitë e ligjëratës së zhdrejtë me anë të dialogut me dy fjali (<i>Rojtari na pyeti kur po largoheshim. Ne i thamë se kishim edhe dy orë. - "Kur po largoheni, nxënës?" "Kemi edhe dy orë, xhaxhi rojtar."</i>)</li> </ul>
<p><b>Shembuj veprimtarish (aktivitetesh)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit dëgjojnë hyrjen (siglën) e një seriali të njohur për fëmijë dhe e identifikojnë atë. Pastaj ndahen në grupe, këndojnë me zë të ulët atë që dëgjuan dhe bëjnë një vizatim me simbolin që e pasqyron përmbajtjen e asaj që kanë dëgjuar. (Si alternativë, dëgjojnë hyrjen (siglën) e një seriali televiziv të njohur muzikor, e njohin atë dhe vizatojnë një shënim, një fytyrë të buzëqeshur etj. si simbol të atij serialin)</li> <li>• Mësimdhënësi jep udhëzime për lojën "Treni" e cila përfshin disa hapa për realizim. Nxënësit radhiten në rreth dhe duke thënë një numër përcaktohet se cili nxënës do të luajë rolin e lokomotivës. Nxënësi i zgjedhur fillon të lëvizë në brendësi të rrethit të nxënësve, duke kënduar: "<i>Treni po largohet, lokomotiva po rrotullohet, eja (emri i nxënësit) të bashkohesh me ne.</i>" Nxënësi, emri i të cilit përmendet, duhet të kapet nga mesi i "lokomotivës". Pastaj ai nxënës këndon këngën duke thërritur emrin e një nxënësi tjetër dhe kështu me radhë derisa të gjithë nxënësit të bashkohen në "tren".</li> <li>• Mësimdhënësi lëshon një regjistrim audio (incizim dëgjimor) nga një operator telefonik që jep udhëzime për veprime të mëtejshme kur kërkohet një shërbim ose informacion. Nxënësit kanë një tastierë me numra përpara tyre dhe e shfrytëzojnë atë për të ndjekur hapat që përcakton operatori për të arritur qëllimin e paracaktuar (shërbim ose informacion). Disa nxënës i prezantojnë veprimet që i kanë marrë.</li> <li>• Nxënësit ndahen në grupe. Mësimdhënësi lëshon dy regjistrime audio (incizime dëgjimore) (mesazhe telefonike, biseda të shkurtra të regjistruara, pjesë të formave të monologut dhe dialogut, fragmente të filmit të animuar etj.). Nxënësit në grupe diskutojnë për numrin e pjesëmarrësve në materialin dëgjimor, nëse zërat që dëgjuan ishin zërat e fëmijëve, e të rriturve dhe nëse ishin djem apo vajza. Secili grup</li> </ul>	



prezanton këndvështrimet e veta para klasës.

- Nxënësit ndahen në grupe. Grupet së bashku dëgjojnë një tekst të shkurtër për bukuritë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pasi të mbarojnë me dëgjimin, secili grup merr një fletë të madhe vizatimi dhe materiale (ngjitës, thjerrëza ose fasule, rruaza, gazeta) për të bërë një punim (poster) me temë "*Vendi im i bukur*". Kur krijojnë punimin (posterin), nxënësit udhëhiqen nga ato që kanë dëgjuar dhe kanë mbajtur mend për vendin e tyre. Secili grup paraqet punën e tyre para gjithë klasës.
- Nxënësit dëgjojnë një tekst që ka përgatitur mësimdhënësi me temën "*Lodra ime e preferuar*". Në tekst theksi bie mbi pamjen e lodrës, qëllimin dhe rëndësinë e tij për fëmijën. Nxënësit në dyshe i përshkruajnë njëri-tjetrit lodrën ashtu siç e kanë imagjinuar gjatë dëgjimit të tekstit. Disa nxënës prezantojnë përshkrimin e vet para gjithë klasës. Diskutojnë pse dallohen përshkrimet e tyre.
- Nxënësit dëgjojnë një tregim të shkurtër (p.sh. *Gjyshi dhe rrepa*). Më pas, të ndarë në grupe përmbledhin përmbajtjen që kanë dëgjuar, duke shkruar tri fjali. Grupet lexojnë me zë fjalitë e shkruara. Përmes një diskutimi të hapur identifikohen personazhet dhe radha në të cilën ato paraqiten dhe më pas përcaktohet edhe vendi dhe koha e veprimit.
- Nxënësit luajnë lojën "*Korrigjo gabimin*". Mësimdhënësi u lexon atyre fjali të palogjikshme, si për shembull: *Peshku fluturon në liqen. Era ngroh në dimër*. Pastaj nxënësit zbulojnë gjërat e palogjikshme dhe shkruajnë fjali të korigjuara duke u siguruar se ato kanë kuptim dhe kështu i ndajnë ndërmjet vete dhe i komentojnë.
- Nxënësit ndahen në katër grupe sipas stinëve të vitit – tërheqin fletën dhe fshehin stinën që u është caktuar. Secili grup, përmes parashtrimit të: 2 pyetjeve *po/jo*, 2 pyetjeve *kush/çfarë*, 2 pyetjeve *ku/kur*, duhet të zbulojë se cilës stinë të vitit i përkasin grupet e tjera, me ç'rast nuk duhet të pyesë drejtpërdrejt se çfarë stine është. Në fund diskutohet se cilat ishin pyetjet kyçe që ndihmuan më shumë në zbulimin e stinës së vitit .
- Mësimdhënësi lexon një tekst të shkurtër që lidhet me një stinë të caktuar të vitit, në të cilin ka fjalë të panjohura për nxënësit. Çdo nxënës ndjek me kujdes, identifikon fjalët e panjohura dhe i shkruan në një fletë. Më pas ndahen në grupe, krahasojnë fjalët e panjohura që kanë identifikuar dhe përpiqen bashkërisht për të përcaktuar kuptimin e tyre. Mësimdhënësi sërish lexon tekstin, ndërsa nxënësit e ndërpresin kur hasin ndonjë fjalë të panjohur dhe fillimisht përpiqen ta sqarojnë vetë, por nëse nuk arrijnë ta sqarojnë, mësuesi ua tregon kuptimin. Fjalët e panjohura shkruhen në tabelë (dërrasë) dhe me secilën prej tyre, nxënësit në grupe, formojnë fjali dhe i lexojnë para të tjerëve.
- Nxënësit dëgjojnë një tekst në të cilin personazhet shprehin pajtimin dhe mospajtimin për diçka ose dikë, besim dhe mosbesim në diçka të shprehur, dyshimi për diçka, habi, pohim dhe mohim, përqeshje dhe zemërim me dikë. Leximi i tekstit ndërpritet pas çdo shtate të tillë dhe nxënësit e shprehin në mënyrë joverbale: me gjeste, me mimika dhe/ose tingullimitime (onomatope) kuptimin e asaj që dëgjojnë. Në diskutim ata bëjnë dallimin midis reagimeve joverbale fyese (p.sh. nxjerrja e gjuhës) dhe reagimeve që përdoren për qëllime të tjera (p.sh. lëvizja e kokës në shenjë pohimi; ngritja e gishtit të madh për pëlqim etj.).
- Nxënësit ndahen në çifte. U jepen detyra të përgjigjen në tri pyetje me përgjigje të shkurtra si: "*Po/Jo*"; "*Mirë*"; "*Kuptohet*"; "*Dakord*"; "*Me të vërtetë?*"; "*Mendon?*"; "*Si jo!*" Pastaj secili çift duhet të formojë tri pyetje shtesë që çojnë në përgjigjet e dhëna. Pyetjet i parashtrohen çiftit tjetër.

- Nxënësve u parashtrohet pyetje në lidhje me të ushqyerit e tyre në shtëpi dhe në shkollë. Disa pyetjet janë me përgjigje *po/jo* e disa të tjera janë me tri përgjigje të mundshme dhe pastaj lexohen fjali që ata duhet t'i plotësojnë. Në fund diskutohet se në cilën situatë ka qenë më e lehtë ose më e vështirë të përgjigjen dhe pse.
- Nxënësit përsërisin tingujt dhe fjalët që i thotë mësimdhënësi ose ato që i dëgjojnë nga një material dëgjimor. Vëmendje e veçantë i kushtohet shqiptimit të drejtë – tingujt të mos stërzgaten, të mos shkurtohen, të mos mbetet asnjë pa e artikuluar, të mos shqiptohen me mërmëritje, më të përparme ose më të prapme, as më të hapura e as më të mbyllura sesa variantet e tyre letrare. Nxënësit i përsërisin aq herë fjalët, derisa të arrijnë t'i shqiptojnë drejt tingujt. Duhet pasur kujdes sidomos që nxënësit të mos shqiptojnë zanore hundore (*sy, dru, pe, hi*); të mos e buzorëzojnë zanoren **a**: *natë*, e jo: *nât*; ta shqiptojnë **ë**-në në fund të fjalës më të shkurtër sesa zanoret e tjera (*shkollë, mollë, nënë, pulë, ëndërr*), të mos e zh buzorëzojnë zanoren **y**: (*ynë, dry, yll, ylber, yndyrë*), bashkëtingëlloret **q** e **gj** të mos i afrikatizojnë në **ç, xh** (*qen, qilim, gjeth, gjel* e jo: *çen, çilim, xheth, xhel*); të dallojnë në shqiptim bashkëtingëlloret **r/rr** (*ara – arra, mora – morra, rrush, rreze*) etj.
- Nxënësit ushtrojnë shqiptimin e fjalëve njërrrokëshe dhe dyrrrokëshe bashkërisht ose në mënyrë të pavarur duke përsëritur tri fjalë në të cilat ekziston i njëjti tingull (pasi dëgjojnë atë që shqipton mësimdhënësi). Fillohet me fjalët e formuara prej dy tingujsh duke rritur më pas numrin e tyre: *pa, sa, tha; mal, hap, kam, lis, arra, nëna, era, dera, tani, ora, dora*.
- Mësimdhënësi tregon fillimisht nga një fjalë e pastaj edhe nga dy. Nxënësit (individualisht) përcaktojnë nëse ka ndonjë tingull që mësimdhënësi do ta theksojë më shumë. Më pas, së bashku zbulojnë se cili tingull është lëshuar ose është shtuar në fjalët e dëgjuara dhe cilat fjalë kanë përbërje ose renditje të gabuar tingujsh dhe në fund i shqiptojnë ata në formën e duhur. Për shembull, nëse në përbërjen tingëllore të fjalëve të mëposhtme është i pranishëm tingulli *e*: *lapsi, dhëmbë, pluhur, fund, pastaj*, ose në fjalët vijuese që shqiptohen njëra pas tjetrës, është i pranishëm tingulli *gj*: *gjethi-xhepi; xhamadani-gjerdani; gishti-gjiza; guri-gruri*. Pastaj nxënësit duhet të zbulojnë nëse ndonjëri prej fjalëve që dëgjojnë i mungon ndonjë tingull apo ndonjë tjetër është shtuar gabimisht dhe nëse përbërja dhe radhitja e tingujve është e drejtë si në shembujt: *ëna, oteli, un, ktu, puntor, dhetë; zembër, mbrenda, mvaret; thkej, elbebi, shëloj* etj.
- Nxënësit punojnë të ndarë nga katër veta në grup, secili parashtron nga një detyrë, kurse të tjerët thonë fjalë duke spikatur tingullin e parë ose të fundit në fjalë, sipas kësaj mënyre: ajo që është *sh* për Shkup, për Dibër është *d*. Për cilin janë: *s, k, g, t* dhe *p*? – Ajo që është *t* për Petrit, për Sara është *a*. Për cilën janë: *e, i, k, n* dhe *r*? Mund të përdoren lloje të ndryshme fjalësh ku nxënësit në fillim i përgjigjen detyrës së dhënë nga mësimdhënësi.
- Nxënësit të ndarë në çifte formojnë nga një fjali e cila do të ketë kuptim për ditën e caktuar (do të ketë një mesazh të mirë). Disa çifte i thonë fjalitë me zë të lartë para të gjithëve, ndërsa nxënësit e tjerë kanë për detyrë të mbajnë mend një fjalë që u ka pëlqyer. Mësimdhënësi kërkon që një nxënës të thotë fjalën që ka mbajtur mend. Më pas mësimdhënësi i shton një fjalë fjalës së dëgjuar dhe kështu me një ose dy fjalë të tjera nxënësit e tjerë vazhdojnë renditjen logjike të fjalëve në fjali - në fund shqiptohet e gjithë fjalia. Kjo përsëritet disa herë. Fjalitë shkruhen në dërrasë dhe mësimdhënësi të njëjtat i lexon me shpejtësi të ndryshme. Nxënësit përsërisin pas mësimdhënësit duke lexuar fjalitë me të njëjtin ritëm.
- Tre nxënës marrin kartela në të cilat janë vizatuar: një pikë, një pikëçuditje dhe një pikëpyetje. Nxënësit e tjerë sjellin shembuj të fjalive thirrmore/nxitëse, pyetëse ose dëftore. Kur njëri nga nxënësit thotë, p.sh. një fjali pyetëse, pranë tij duhet të qëndrojë nxënësi që ka

kartelën me pikëpyetje. Veprimtaria përsëritet disa herë edhe me nxënësit e tjerë me qëllim që të ushtrohet intonacioni gjatë shqiptimit të fjalive përkatëse.

- Nxënësit ndahen në çifte. Njëri fillon bisedën se ku do të donte të shkonte në piknik me klasën, ndërsa tjetri dëgjon dhe më pas vazhdon të shprehë mendimin e tij ose të bëjë ndonjë pyetje. Gjatë bisedës ata ndërlihen me njëri-tjetrin.
- Nxënësit luajnë role: njëri është nxënës dhe tjetri është ose mësimsdhënës, ose drejtor, ose psikolog, ose punëtor teknik. “Nxënësi” e nis bisedën duke dhënë mendimin e tij për diçka në shkollë dhe parashtrohet pyetje, ndërsa tjetri nga çifti përgjigjet. Pastaj rolet ndryshohen, “nxënësi” merr rolin “mësimsdhënës” ose dikush tjetër nga shkolla e tjetri rolin e nxënësit dhe kështu procedura përsëritet. Disa çifte e përsërisin bisedën para të gjithëve
- Nxënësit të ndarë në grupe, aktrojnë situata (p.sh. bisedë gjatë ngjitjes drejt një maje mali; bisedë për shokët e lagjes; bisedë telefonike në grup me një shok që ka këmbën e thyer dhe mungon në klasë; bisedë për fotot e bëra në një festë ditëlindjeje të një shok klase; bisedë me bibliotekarin e shkollës, nga i cili kërkojnë libra për një projekt të përbashkët; bisedë familjare për përshtypjet e një vizite në shtëpinë e një shoku që feston Bajramin; bisedë me fqinjët më të vjetër gjatë një aksioni të përbashkët për pastrimin e parkut etj.) në të cilat ata përdorin mënyra të përcaktuara të përshëndetjes, lamtumirës, prezantimit, përshkrimit, lutjes, kërkimfaljes etj. Gjatë dramatizimeve nxënësit përdorin lartësinë e duhur të tonit në të folur, varësisht nga situata e komunikimit dhe e bashkëbiseduesit.
- Nxënësit dëgjojnë materiale dëgjimore (audio) ku përshkruhet rrjedha e një ngjarjeje (p.sh. çfarë bën një nxënës kur vendos të kopjojë detyrat e shtëpisë nga shoku i klasës, pa dijeninë e tij: hapa, mora, fillova të kopjoj, erdhën, pyetën). Më pas, nxënësit në çifte ritregojnë ngjarjen (njëri fillon bisedën, tjetri i bashkëngjitet). Më pas, një nxënës e ritregon ngjarjen para të gjithëve e të tjerët plotësojnë nëse anashkalohet diçka. Gjatë ritregimit të ngjarjes, foljet përdoren në një formë tjetër: hapi, mori, filloi të kopjojë, erdhi, pyeti.
- Disa nxënës tregojnë gojarisht përshtypjet e tyre për festën e ditëlindjes së një shoku të tyre duke përdorur fjalorin e duhur dhe format gramatikore për të përshkruar ngjarjen (p.sh. për lulet në oborr, për kafshët e përkëdhelura shtëpiake, për dhuratën, për mënyrën se si u argëtuan, se si arritën dhe si u larguan nga festa, si u ndjenë dhe si u soll ai që festonte etj.)
- Nxënësit punojnë në grupe prej gjashtë vetash. Gjysma e grupeve marrin ilustrime që paraqesin një familje në pushime me dy fëmijë, njëri prej të cilëve është i verbër. Gjysma tjetër e grupeve marrin ilustrime që paraqesin një garë qyteti ku shfaqen njerëz me aftësi të kufizuara fizike. Çdo nxënës në grup mendon një fjalë në lidhje me materialin e dhënë dhe e paraqet atë para të tjerëve në grupin e vet. Në fund secili grup prezanton ilustrimin me fjalitë e tyre para të gjithëve.
- Nxënësit punojnë në çifte. Gjysma e çifteve përpilojnë shprehje me gojë me nga dy fjali secili, duke përdorur fjali dëftore, pyetëse, nxitëse, pohuese dhe / ose mohuese, sipas udhëzimeve të mësuesit. Çiftet e tjera përpilojnë një shprehje me gojë me dy fjali në ligjëratën e zhdrejtë. Pastaj secili çift tregon fjalitë e tyre dhe i shndërron ata nga dialogu dhe anasjelltas (*Shqipe, ma jep librin, të lutem! - Prit sa ta përfundoj detyrën, Leart! / Learti iu lut Shqipes që t'ia jepte librin. Shqipja i tha që të priste derisa ta përfundonte detyrën.*). Ushtrimi mund të përsëritet edhe në anën e kundërt, nga ligjëratat e zhdrejtë në ligjëratën e drejtë (- *Lina, dëshiron që nesër të shëtisim bashkë me biçikletë? – Mundet Matin, rreth banesës sime kemi një shteg të bukur biçikletash. / Matini e pyeti Linën nëse dëshironte të ngjnin nesër biçikletën së bashku. Lina pranoi dhe i tha Matinit se ata kishin një shteg të bukur biçikletash rreth ndërtesës së saj. // Prezantuesi tha se loja shpërblyese*

do të zgjasë edhe një muaj. Agnesa e pyeti nënën e saj nëse mund të merrte pjesë. /- Prezantuesi: “Loja shpërblyese do të zgjasë edhe një muaj.” Agnesa: Mami, a mund të marr pjesë? ”).

Fusha programore: **LEXIMI DHE SHKRIMI FILLESTAR**

Gjithsej: **65 orë**

**Rezultatet e të nxënit:**

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të lexojë me të kuptuar fjalë, fjali dhe tekste të shkurtra të shkruara në materialin mësimor dhe në mjedisin ku jeton;
2. të shkruajë shkronjat e vogla e të mëdha të dorës të alfabetit të gjuhës shqipe dhe t’i përdorë si duhet kur shkruan fjalë e fjali;
3. të shkruajë tekste të shkurtra e të thjeshta sipas diktimit, rikujtimit dhe në mënyrë të pavarur, për një temë të caktuar;
4. të zbatojë rregullat drejtshkrimore themelore për përdorimin e shkronjës së madhe e të vogël, për shenjat e pikësimit: pikën, pikëçuditjen e pikëpyetjen dhe për bartjen në rreshtin tjetër të një rrokjeje nga fjala dyrrrokëshe.

**Përmbajtjet (dhe konceptet):**

**Standardet për vlerësim:**

- **Leximi fillestar**  
(tingull, rrokje, fjalë, fjali e thjeshtë, fjali e shkurtër, alfabet)

- I thotë shkronjat sipas renditjes alfabetike.
- I njeh shkronjat, i lidh ato me tingullin përkatës si dhe me fjalët që fillojnë me atë tingull.
- I lidh shkronjat e shtypit dhe të dorës me tingujt përkatës.
- I njeh shkronjat e dorës në përbërje të një rrokjeje, të një fjale ose të një fjalie.
- Identifikon pas dëgjimit shkronjën, rrokjen ose fjalën në një tekst të shkruar.
- Lexon shkronja, rrokje, fjalë dhe fjali të thjeshta / të shkurtra në tekste të ndryshme (materiale mësimore, libra, revista, reklama, njoftime, emra artikujsh / produkte, posterë, mesazhe, formularë, mbishkrime, tabela, grafitë, vitrina etj.).
- Lexon fjali të thjeshta dhe të shkurtra që përmbajnë fjalë të reja të sapomësuar.
- Identifikon fjalët e panjohura në një tekst të shkruar.
- U përgjigjet pyetjeve të shkurtra të cilat i lexon.
- Dallon fjalitë dëftore, pyetëse e nxitëse në një tekst dhe i lexon ato me intonacionin e duhur.
- Përpilon pyetje pas leximit të një fjalie të shkurtër pohore.
- Përpilon fjali të shkurtra mohuese nga fjalitë e lexuara pohuese dhe anasjellas.
- I dallon fjalët dhe fjalitë në tekstin e shkruar si përgjigje të pyetjes lidhur me përmbajtjen e tekstit të dëgjuar.
- Përpilon pyetje në lidhje me përmbajtjen e një teksti të lexuar.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shndërron fjalitë e lexuara duke i kthyer ato nga numri njëjës në numrin shumës dhe anasjellas, duke i bashkuar dy fjali në një dhe duke zëvendësuar emrin e përveçëm me një përemër vetor.</li> <li>• Shndërron fjalitë e lexuara nga fjali dëftore në fjali pyetëse dhe nxitëse dhe anasjellas, gjegjësisht nga fjali pohuese në fjali mohuese dhe anasjellas.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Shkrimi fillestar</b> (shkronja dore, shkronja të vogla, shkronja të mëdha, pikë, pikëpyetje, pikëçuditje, alfabet)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bën dallimin midis shkronjave të dorës dhe atyre të shtypit.</li> <li>• I shkruan shkronjat e dorës (të vogla dhe të mëdha).</li> <li>• Shkruan fjalë dhe fjali të shkurtra me shkronja të dorës.</li> <li>• Shkruan përmbajtje të thjeshtë gjuhësore (lidh tingujt dhe shkronjat në një fjalë të plotë, fjalë në një fjali) pasi i dëgjon ato.</li> <li>• Përdor shkronjën e madhe në fillim të një fjalie të cilën e shkruan pasi e ka dëgjuar.</li> <li>• Shkruan tekste të thjeshta dhe të shkurtra gjatë diktimit.</li> <li>• Në mënyrë të pavarur shkruan një tekst të thjeshtë, duke rikujtuar një tekst të dëgjuar më parë ose një tekst të mësuar përmendsh.</li> <li>• Shkruan një tekst të shkurtër për një temë të dhënë.</li> <li>• Kur shkruan i ndan në rrokje fjalët që ka dëgjuar.</li> <li>• Kur shkruan i bart saktë pjesët e fjalëve në rreshtin tjetër.</li> <li>• Shkruan saktë shenjën e pikësimit në fund të fjalisë.</li> <li>• I shkruan me shkronjë të madhe emrat e përveçëm dhe mbiemrat, si dhe emrat e vendbanimeve.</li> <li>• I shkruan me fjalë numrat deri në 100 dhe mbiemrat marrëdhëniorë (numërorët rendorë) deri në 10.</li> <li>• Njih renditjen e gabuar të shkronjave në fjalët e shkruara dhe rendin e pasaktë të fjalëve në fjalitë e shkruara dhe i rishkruan saktë fjalët, përkatësisht fjalitë.</li> <li>• Dallon gabimet në tekstin e shkruar (shkronjat e lëna, rrokjet, fjalët, pjesët e një fjalie, shenjat e pikësimit) dhe e rishkruan saktë tekstin.</li> <li>• Shkruan fjali që përfshijnë fjalë të reja të sapomësuara.</li> </ul>
<p><b>Shembuj veprimtarish (aktivitetesh)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit këndojnë këngë për alfabetin e gjuhës shqipe dhe e shkruajnë atë.</li> <li>• Nxënësit së pari ushtrojnë të shkruajnë elemente të shkronjave të dorës, kurse mandej i shkruajnë ato shkronja, elementet e të cilave i kanë ushtruar.</li> </ul>	

- Nxënësve u jepet një listë me shkronja të shtypit (të mëdha dhe të vogla) dhe pranë secilës prej tyre e shkruajnë shkronjën e njëjtë të dorës.
- Nxënësve u jepen vargje fjalësh dhe lexojnë: *tip, top, tap; luaj, ruaj, muaj; mall, shall, tall; besë, pesë, vesë*. Prej tyre kërkohet ta vërejnë ndryshimin e kuptimit të fjalës kur ndryshon një shkronjë. Nxiten të japin shembujt e tyre.
- Çdo nxënësi i jepet nga një fletë me dy kolona – njëra me shkronja të mëdha dhe tjetra me shkronja të vogla. Nga ata kërkohet t'i lidhin shkronjat e vogla me të mëdhatë dhe të thonë një fjalë që fillon me atë tingull / shkronjë ose ndonjë fjalë e cila do ta përmbajë atë tingull në mes ose në fund të fjalës.
- Çdo nxënësi i jepet një fletë ku janë shkruar tri rreshta me nga dhjetë shkronja të dorës (të vogla dhe të mëdha). Nxënësit lexojnë me radhë nga një shkronjë, ashtu si do t'u vijë radha, sa më shpejt të mundet. Sa herë që lexohet ndonjë shkronjë gabim, mësimdhënësi ua ndërpret nxënësve leximin dhe rifillon pasi korrigjon gabimin.
- Nxënësit ndahen në grupe me nga katër veta duke marrë një tabelë me katër kolona me fusha në të cilat janë shkruar fjalë të ndryshme. Secili prej tyre hedh zarin dhe lexon fjalën mbi të cilën do të ndalojë zari. Nëse e lexon gabim fjalën, kthehet prej fillimi. Nxënësi që arrin në fund fillon turrin e ri, derisa të jepet sinjali për përfundimin e lojës.
- Mësuesi u lexon fjali që fillojnë me një shkronjë të caktuar që mësohet gjatë orës së mësimin. Nxënësve u jepet një fletë pune me fjalë ku duhet të njohin dhe të nënvizojnë shkronjën e re të mësuar. Kur të përfundojnë, shkëmbejnë fletën e punës me shokun pranë tyre dhe kontrollojnë saktësinë e përgjigjeve.
- Mësimdhënësi u jep nxënësve një fletë pune në të cilën ka një tregim me ilustrime. Nxënësit kanë për detyrë të shkruajnë një tregim duke ndjekur veprimet e paraqitura në ilustrime.
- Nxënësit të ndarë në grupe, tërheqin kartela me fjali që përmbajnë fjalë të panjohura. Brenda grupit ata identifikojnë fjalën e panjohur dhe përpiqen të zbulojnë kuptimin e saj. Fjalën e panjohur e lexojnë para të gjithëve, e shkruajnë në tabelë dhe tregojnë çfarë mendojnë për kuptimin e saj. Mësimdhënësi ua shpjegon kuptimin e fjalës dhe secili grup formulon nga një fjali të re me fjalën e sapomësuar.
- Nxënësit punojnë në çifte – njëri lexon një tekst të shkurtër, kurse tjetri dëgjon me kujdes dhe parashtron pyetje të formës *po / jo* dhe pyetje me fjalët pyetëse: *kush?, kur?, ku?*. Pyetjeve u përgjigjet nxënësi që e ka lexuar tekstin. Pastaj i ndërrojnë rolet. Në fund diskutohet se cili rol ishte më i vështirë dhe / ose më interesant për ta.
- Nxënësve u jepet një fletë pune me një tregim të shkurtër që nuk ka shenja pikësimi. Ata kanë për detyrë të vendosin shenjat e duhura të pikësimit dhe të lexojnë tekstin me ngritje të zërit sipas shenjave të shënuara të pikësimit.
- Nxënësit qëndrojnë në rreth dhe kanë një top (mund të jetë prej gome ose shuk letre). Kur jep shenjë mësimdhënësi, nxënësi i parë me topin në dorë thotë një fjali pohuese dhe ia hedh atë nxënësit tjetër, i cili ka për detyrë së pari ta shndërrojë atë në fjali pyetëse dhe pastaj të thotë një fjali të re pohuese duke përcjellë topin te nxënësi i tretë. Procedura përsëritet derisa të gjithë nxënësit të kenë thënë të paktën nga një fjali (Si alternativë, loja mund të luhet edhe me një lësh tjerri dhe të përfundojë me rrjetën e merimangës.)
- Mësimdhënësi u shpërndan nxënësve, të ndarë në çifte, nga 5 ilustrime. Secili nxënës nga çiftet ka për detyrë që vetë të shkruajë me shkronja të dorës nga një fjali pohuese për çdo ilustrim. Pas kësaj i shkëmbejnë fjalitë e shkruara, i shndërrojnë ato dhe i shkruajnë si fjali mohuese.
- Nxënësit të ndarë në grupe marrin fleta pune me një tekst të shkruar (tregim) dhe me pyetje në lidhje me tregimin. Ata kanë detyrë t'i

gjejnë dhe t'i nënvizojnë pjesët e tekstit nga të cilat dalin përgjigjet e pyetjeve.

- Mësimdhënësi lexon një tekst, nxënësit përpilojnë pyetje në lidhje me përmbajtjen e tekstit të lexuar. Pastaj disa lexojnë pyetjet, të tjerët u përgjigjen atyre.
- Nxënësve u jepen fleta pune dhe në çift i kthejnë fjalitë e lexuara: (1) nga njëjës, në shumës: (p.sh. *Unë shkruaj. Ne shkruajmë. / Ela ecën. Ela dhe Adriani ecin. / Mbrëmë hëngra një akulllore dhe një pjeshkë. Mbrëmë hëngra dy akulllore dhe dy pjeshka.*); (2) duke zëvendësuar emrin e përveçëm me një përemër vetor (p.sh. *Noriku dhe Teuta shikojnë një film. Ata shikojnë një film. / Noriku ulet në dysheme, ndërsa Teuta në divan. Ai ulet në dysheme, ndërsa ajo në divan.*); (3) duke e kthyer fjalinë nga një lloj në tjetrin (dëftore, pyetëse, nxitëse: p. sh. *Pi qumësht nga gota. Pi qumësht nga gota? Pi qumësht nga gota!*); (4) nga fjalia pohuese në fjali mohuese dhe anasjellas (p.sh. *Do të vij në ditëlindje. Nuk do të vij në ditëlindje.*).
- Nxënësit lexojnë individualisht një tekst që përmban fjali të shkurtra, pastaj gjejnë dy fjali që mund të bashkohen në një (p.sh. *Anda fle. Hëna shkëlqen në dhomën e saj. Anda fle, kurse hëna shkëlqen në dhomën e saj.*)
- Mësimdhënësi përmend disa shembuj me fjali dëftore, pyetëse e nxitëse dhe secilën fjalë të tyre e shkruan në fleta të veçanta letre (p.sh. *Florina dhe Omeri luajnë me top.; Ku hanë ëmbëlsira Enisi dhe Nina?*) Nxënësit ndahen në grupe, po aq sa fjalë ka në një fjali. Secili nxënës nga grupi tërheq nga një fletë. Secili grup ka për detyrë t'i radhisë anëtarët e vet në mënyrë që të formojnë fjali me të gjitha fjalët e dhëna. Më pas i lexojnë ato me intonacionin e duhur dhe i krahasojnë fjalitë që kanë formuar duke përcaktuar se cila është fjali dëftore, cila fjali pyetëse dhe cila fjali nxitëse.
- Çdo nxënësi i jepet nga një fletë me shkronja të mëdha të dorës, për të formuar fjalë dhe të njëjtat t'i shkruajë me shkronja të vogla të dorës. Me shokun/shoqen e bankës e kontrollon saktësinë e fjalës së shkruar.
- Mësuesi përgatit kartela bingo me 15 shkronja për secilin nxënës dhe një komplet tjetër me të gjitha shkronjat veçmas duke i vendosur në një enë të tejdukshme. Nxënësit një nga një tërheqin nga një shkronjë duke e lexuar me zë, ndërsa të tjerët duhet të qarkojnë në fletët e tyre. Fituesi i bingos është ai që do të jetë i pari që do t'i qarkojë të gjitha shkronjat e dëgjua në kartelën e tij dhe do të thërrasë "Bingo!"
- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet kompleti i njëjtë prej së paku 15 kartelash me shkronja nga të cilat mund të krijohen shumë fjalë me nga 3-5 shkronja. Grupet kanë për detyrë të krijojnë sa më shumë fjalë. Secilën fjalë që kanë krijuar duhet ta shkruajnë me shkronja të dorës në një fletë të veçantë. Pas përfundimit të veprimtarisë, grupet i ngjisin fletët në tabelë, i lexojnë me zë dhe i krahasojnë.
- Secilit nxënës i jepet një fletë pune me rrokje të ndryshme. Rrokjet i përdor: (1) për të zbuluar se cilat prej tyre mund të paraqesin fjalë njërrrokëshe; (2) për të krijuar fjalë dyrrrokëshe dhe (3) nga fjalët e krijuara të hartojë fjali të shkurta. Më pas fjalitë i shkruan me shkronja të dorës, ndërsa njëren prej tyre e lexon me zë.
- Nxënësve u jepet një tekst me gabime (fjalitë janë të shkruara me shkronjën e parë të vogël). Ata kanë për detyrë t'i gjejnë gabimet, t'i korrigjojnë ato dhe ta rishkruajnë saktë tekstin me shkronja të dorës.
- Mësimdhënësi lexon tekste të thjeshta dhe të shkurtra, ndërsa nxënësit dëgjojnë me kujdes dhe shkruajnë me shkronja të dorës atë që dëgjojnë. (p.sh. *Gjyshja është në treg. Gjyshi po luan shah. Diana vizaton fluturake. Do t'ia tregojë gjyshes kur të kthehet nga treg.*)
- Nxënësve u jepen udhëzime të shkruara se si të krijojnë një tekst. Te udhëzimet tregohet tema (p.sh. *Me çfarë dua të luaj*), numri dhe lloji i fjalive që duhet t'i shkruajnë (p.sh. shkruaj 4 fjali nga të cilat njëra duhet të jetë fjali pyetëse) dhe si duhet t'i shkruajnë (p.sh. titulli duhet të

jetë me shkronja të shtypit, ndërsa teksti me shkronja të dorës). Disa nxënës lexojnë atë që kanë shkruar dhe pastaj diskutojnë se cilat ishin udhëzimet dhe nëse i kanë respektuar të gjitha).

- Nxënësve u jepet një tekst ku në çdo rresht të tij ka fjalë që kalojnë në rreshtin tjetër, disa prej tyre në formë të drejtë e disa në formë të gabuar. Nxënësit duhet ta lexojnë tekstin, t'i gjejnë fjalët e ndara gabimisht në fund të rreshtit dhe të tregojnë se si duhet të ndahen në mënyrë të drejtë.
- Mësimdhënësi dikton 30 fjalë, kurse nxënësit i shkruajnë ato. Është detyrë e secilit nxënës t'i përdorë këto fjalë për të ndërtuar 3 fjali në të cilat do të përdorë shenja të ndryshme pikësimi (pikëpyetje, pikëçuditje, pikë dhe presje). Nxënësit i shkruajnë në fletore fjalitë me shkronja të dorës dhe i thonë me gojë ato.
- Nxënësve u jepet fleta pune me fjalë të cilat shënojnë emra që fillojnë me shkronjë të madhe dhe fjalë (emra të përgjithshëm) që fillojnë me një shkronjë të vogël. Nxënësit punojnë në çift dhe kanë për detyrë të përcaktojnë ndryshimet midis fjalëve që shkruhen me shkronja të vogla dhe atyre që shkruhen me shkronja të mëdha. Pastaj shkruajnë në fletore emra të disa rrugëve, të qyteteve dhe të shitoreve duke përdorur shkronjën e madhe.
- Nxënësve u jepet një fletë pune me emra: emra të përveçëm të njerëzve dhe të beniaminëve, me nocione gjeografike, me emrin e shkollës. Rrethojnë çfarë është shkruar saktë dhe e kontrollojnë së bashku në klasë.
- Çdo nxënës tërheq nga gjashtë kartela me numra deri në 100 dhe dy kartela me mbiemra marrëdhëniorë (numërorë rendorë) deri në 10 dhe po ata i shkruajnë me fjalë në fletore. Numrat, sidomos ata që janë më të ndërlikuar dhe/ose të veçantë, shkruhen me fjalë në tabelë.
- Nxënësve u jepet një tekst me gabime (renditje e gabuar e shkronjave në fjalët e shkruara dhe renditje e gabuar e fjalëve në fjalitë e shkruara). Ata kanë për detyrë t'i gjejnë gabimet, t'i korrigjojnë ato dhe t'i shkruajnë drejt fjalët dhe fjalitë.
- Nxënësve u jepet fleta mësimore me fjalë dhe fjali të shkurtra në të cilat nuk janë shënuar shkronjat, rrokjet, fjalët, pjesët e një fjalie, shenjat e pikësimit. Nxënësit duhet t'i gjejnë gabimet dhe ta shkruajnë tekstin si duhet.
- Nxënësit punojnë në çifte rreth një vjershe të caktuar ku ka fjalë të panjohura. Ata nënvizojnë fjalët e panjohura dhe gjatë një diskutimi të hapur zbulojnë kuptimin e tyre. Në fund, e mësojnë vjershën përmendsh.
- Nxënësit zgjidhin një fjalëkryq në të cilin udhëzimet janë dhënë me ilustrime (p.sh. 1. Vertikalisht: ☼). Këshillohet që fjalëkryqi të përgatitet në mënyrë tematike, me koncepte (nocione) që i kanë mësuar në lëndët e tjera.

Fusha programore: **LETËRSIA, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA**

Gjithsej: **60 orë**

#### **Rezultatet e të nxënësve:**

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të dallojë llojet e teksteve letrare (tregim, kallëzim, përrallë, përrallëz, vjershë, dramë);
2. të analizojë përmbajtjen e një teksti letrar (personazhet, ngjarjet, vendin dhe kohën kur ndodhin);
3. të ritregojë tekste letrare me fjalët e veta;
4. të tregojë (me gojë e me shkrim) rreth një teme të caktuar dhe një teme me zgjedhje.



Nxënësi/nxënësja: 5. do të zhvillojë të shprehurit krijues.	
<b>Përmbajtjet (dhe konceptet):</b>	<b>Standardet për vlerësim:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Llojet e teksteve letrare</b> (tregim, përrallë, përrallëz, vjershë, dramë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bën dallimin ndërmjet tregimit, përrallës dhe përrallëzës.</li> <li>• Përmend disa veçori dalluese të dramës (dialogun, personazhet).</li> <li>• Vë në pah disa veçori dalluese të vjershës (vargun, strofën, rimën).</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Analiza e teksteve letrare</b> (temë, ngjarje, personazh, kohë, vend)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton temën e një teksti letrar që ka lexuar.</li> <li>• Përcakton kohën dhe vendin e ngjarjeve të një teksti letrar që ka lexuar.</li> <li>• Përcakton ngjarjet dhe renditjen e tyre në një tekst letrar që ka lexuar</li> <li>• Dallon hyrjen, mesin dhe përfundimin e një kallëzimi.</li> <li>• Njeh dhe krahason personazhet e një teksti letrar që ka lexuar dhe ndërlidh veprimet që bëjnë ata me karakteristikat e tyre.</li> <li>• U përgjigjet pyetjeve rreth tekstit letrar që ka lexuar lidhur me personazhet dhe/ose përmbajtjen e tij.</li> <li>• Nxjerr porosinë e përmbajtjes së një vjershe të thjeshtë.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të shprehurit me gojë e me shkrim dhe të krijuarit</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ritregon me fjalët e veta një tekst letrar.</li> <li>• Tregon ngjarje nga jeta e përditshme që kanë ngjashmëri me ato në tekstin letrar.</li> <li>• Rrëfen rreth një teme të përcaktuar ose për temën që e ka zgjedhur vetë.</li> <li>• Krijon një fillim tjetër ose një përfundim të ndryshëm të një teksti letrar që ka lexuar.</li> <li>• Tregon sipas një serie fotografish ose ilustrimesh.</li> </ul>
<b>Shembuj veprimtarish</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mësimdhënësi lexon një tregim (p.sh. nga Zoki Poki), kurse nxënësit ndjekin tekstin para vetes duke lexuar pa zë. Pastaj bëhet një diskutim i hapur rreth veçorive të tregimit sipas këtyre pyetjeve: (1) Si është shkruar teksti (me fjali që ndërlidhen me njëra-tjetrën), (2) Sa personazhe kryesore ka? Cilët janë ata? (zakonisht ka një personazh kryesor në çdo tregim) dhe (3) Për çfarë bëhet fjalë? (përshkruan një ngjarje që lidhet me personazhin kryesor). Në fund, disa nxënës e ritregojnë tregimin me fjalët e veta.</li> <li>• Mësimdhënësi lexon një përrallë (p.sh. Gjysmagjeli), kurse nxënësit ndjekin tekstin para vetes duke lexuar pa zë. Disa nxënës e rrëfejnë përrallën. Pastaj bëhet një diskutim i hapur rreth veçorive të përrallës sipas këtyre pyetjeve: (1) A mund të ndodhë vërtet në jetë ngjarja e përshkruar në përrallë? Përse? (ngjarja është joreale, duken të pabesueshme sjellja dhe veprimet e gjysmagjelit, nuk mund të flasin e të</li> </ul>	

sillen kafshët si njerëzit); (2) Çfarë e dallon këtë përrallë nga tregimi? (në tregim nuk ka ngjarje joreale dhe personazh joreal); (3) Çfarë ka të ngjashme përralla me tregimin? (që të dyja shkruhen me fjali që ndërliken me njëra-tjetrën dhe të dyja rrëfëhet për ndonjë ngjarje).

- Mësimdhënësi lexon një përrallëz (p.sh. Luani dhe miu), ndërsa nxënësit ndjekin tekstin para vetes duke lexuar pa zë. Pastaj bëhet një diskutim i hapur rreth veçorive të përrallëzës sipas këtyre pyetjeve: (1) Çka mësuam nga kjo përrallëz?; (2) Cilët ishin personazhet e kësaj përrallëze? Çfarë vetish kanë ato?; (3) A janë vetitë e treguara në përrallëz karakteristike për kafshët apo për njerëzit? Përse?; (4) Çfarë e dallon këtë përrallëz nga tregimi? (personazhet janë kafshë me veti njerëzish); (5) Çfarë e dallon këtë përrallëz nga përralla? (në përrallë ka personazhe me fuqi magjike, ndërkaq te përrallëza kafshët kanë veti njerëzish).
- Mësimdhënësi lexon një dramë të shkurtër për fëmijë ose një pjesë të shkëputur nga një dramë e gjatë. Mandej ua cakton rolet e personazheve disa nxënësve dhe secili e lexon rolin e tij, duke u përpjekur “të aktrojë” personazhin. Pas kësaj diskutohet për veçoritë e dramës: dialogu, personazhet.
- Mësimdhënësi lexon një vjershë, ndërsa nxënësit e ndjekin atë në formën e shkruar. Disa nxënës e lexojnë vjershën me zë. Pastaj diskutojnë për mënyrën se si është shkruar ajo (një fjali në disa rreshta) dhe për veçoritë e tjera dalluese të vjershës: vargu, strofa, rima
- Nxënësit e lexojnë tregimin “Gjinkalla dhe milingona”. Mësimdhënësi me anë citimesh, për të cilat kërkon komentime, si dhe pyetjeve që bën i udhëzon nxënësit ta përcaktojnë temën e saj (përgjegjshmërinë dhe zellin e milingonave kundrejt pakujdesisë dhe përtacisë së gjinkallës).
- Mësimdhënësi lexon një vjershë të rëndomtë. Nxënësit shprehin mendimin e vet për mënyrën si e kanë përjetuar përmbajtjen e vjershës dhe së bashku nxjerrin përfundimin për porosinë e përmbajtjes së vjershës.
- Nxënësit punojnë në fleta pune. Në krye është teksti në prozë që duhet ta lexojnë, kurse në pjesën e poshtme të fletës së punës, me teknikën “Ylli i tregimit”, nxënësit duhet të përcaktojnë personazhet, kohën dhe vendin.
- Mësimdhënësi e lexon disa herë tregimin “Dy shokët”. Nxënësit, të ndarë në dyshe/treshe, marrin tregimin e ndarë në fjali (secila fjali e shkruar në një shirit/fletë të veçantë) dhe kanë për detyrë t’i bashkojnë fjalitë duke i radhitur sipas asaj që kanë dëgjuar. Disa grupe e lexojnë tregimin "e kompozuar" dhe pastaj përcaktohet saktësia e bashkimit të tyre. Në fund diskutojnë për miqësinë dhe shkruajnë nga një fjali duke e përshkruar atë ashtu siç e kuptojnë ata vetë
- Mësimdhënësi e lexon përrallëzën “Milingona dhe pëllumbi”, ndërsa nxënësit përcaktojnë se çfarë ndodh në fillim të përrallëzës, çfarë ndodh në mes dhe çfarë ndodh në fund të saj me anë të këtyre pyetjeve: Kush ka nevojë për ndihmë në fillim të tekstit? Si shpëton nga ajo situatë? Pastaj kush tjetër ka nevojë për ndihmë dhe si shpëton?
- Nxënësit dëgjojnë “Hirushen”. Duke përdorur teknikën “Ndal!”, mësimdhënësi i ndalon disa herë gjatë leximit të tekstit dhe me anë pyetjesh i nxit nxënësit që t’i gjejnë personazhet dhe veprimet e tyre. Në fund të tregimit bëjnë krahasimin e personazheve sipas tipareve që dalin nga veprimet e tyre.
- Mësimdhënësi lexon fabulën “Lepuri dhe breshka”. Nxënësit dy nga dy diskutojnë për veprimet e lepurit dhe për veprimet e breshkës te kjo përrallëz dhe shpjegojnë se si arrin në cak breshka ndonëse ecën shumë ngadalë (se është këmbëngulëse) dhe pse lepuri nuk arriti i pari edhe pse në të vërtetë ai është më i shpejtë (në vend që të derdhte djersë, ai e tallte breshkën). Në fund nxënësit marrin rolin e lepurit e të breshkës dhe e dramatizojnë fabulën.

- Nxënësit ritregojnë me fjalët e veta një tekst që kanë lexuar.
- Nxënësit tregojnë një ngjarje të përjetuar, por atëherë kur e kanë ndier që dikush i ka trajtuar në mënyrë të pandershme (p.sh. i ka gënjyer, i ka mashtruar, i ka spiunuar)
- Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur një tekst dhe më pas diskutojnë rreth tij duke iu përgjigjur tri pyetjeve: A u ka pëlqyer? Cila pjesë apo i gjithë teksti u ka pëlqyer dhe pse? Pastaj ndryshojnë tekstin: krijojnë një fillim të ri ose një fund të ri.
- Nxënësve u jepen tregime me ilustrime dhe me radhitje të përzier imazhesh që duhet t'i radhisin sipas rendit logjik dhe në bazë të kësaj të shkruajnë një tekst të shkurtër.

Fusha programore: ***NJOHURI MEDIATIKE DHE KULTURË E MEDIËS***

Gjithsej: **15 orë**

**Rezultatet e të nxënit:**

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të dallojë dhe të përmendë llojet e ndryshme të medies;
2. t'i kuptojë mesazhet mediatike dhe të bëjë dallimin midis njoftimit, reklamimit dhe dhënies së udhëzimeve;
3. të identifikojë dhe të interpretojë informacionet dhe mesazhet në përmbajtjet mediatike tekstuale, ilustruese dhe digjitale për njoftimin, për dhënien e udhëzimeve dhe për reklamimin;
4. të krijojë mesazhe mediatike të shkurtra për të njoftuar, për të dhënë udhëzime dhe për të reklamuar.

**Përmbajtjet (dhe konceptet):**

**Standardet për vlerësim:**

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e medimeve (medime të shtypura, medime vizuale, medime interneti)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmend burimet e mesazheve dhe përmbajtjeve mediatike (revistë, radio, televizion, tabelë lajmërimesh, pllakat, fletëpalosje, internet, telefon celular).</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e mesazheve mediatike (njoftim, udhëzim, reklamë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmend burimet e mesazheve mediatike (revistë, radio, televizion, tabelë lajmërimesh, pllakat, fletëpalosje, internet, telefon celular).</li> <li>• Bën dallimin mes mesazheve mediatike për njoftim, për dhënie udhëzimesh dhe për reklamim.</li> <li>• Nxjerr informacionin e rëndësishëm nga llojet e ndryshme të mesazheve mediatike.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpretimi dhe përdorimi i përmbajtjeve mediatike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon mesazhin thelbësor në përmbajtjet mediatike tekstuale të shkruara me shkronja me madhësi / trashësi të ndryshme dhe / ose me ngjyra të ndryshme.</li> <li>• Identifikon mesazhin thelbësor në përmbajtjen mediatike me ilustrime sipas madhësisë, pozicionit dhe ngjyrës së objekteve të paraqitura.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njeh kuptimin e ikonave digjitale (emotikon-et, gif-et dhe meme-t) në aplikacionet celulare dhe kompjuterike.</li> <li>• Krijon fjalë e shprehje kyçe të ndryshme dhe zgjedh ilustrime përkatëse e ikona digjitale si bazë për dërgimin e një mesazhi mediatik.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i mesazheve dhe përmbajtjeve mediatike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjedh përmbajtjen mediatike për të prezantuar koncepte dhe për të përpunuar temat.</li> <li>• Përpilon një mesazh të shkurtër mediatik në formë reklame, udhëzimi dhe njoftimi.</li> </ul>
<p><b>Shembuj veprimtarish (aktivitetesh)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mësimdhënësi prezanton shembuj mediumesh të ndryshme (të shtypura, vizuale ose medime-internet), kurse nxënësit duhet ta përcaktojnë se për çfarë tipa mediumesh bëhet fjalë. Nëpërmjet diskutimit nxënësit duhet ta kuptojnë se ç'do të thotë koncepti medium, çfarë tipa mediumesh ka dhe çfarë përmbajtjesh mund të transmetojnë ato (tekst, fotografi, vizatime, përmbajtje vizuale).</li> <li>• Mësimdhënësi prezanton lloje të ndryshme mesazhesh dhe përmbajtjesh mediatike të destinuara për medime të ndryshme (revistë, radio, televizion, tabelë lajmërimesh, pllakat, fletëpalosje, internet, telefon celular). Nxënësit, të ndarë në grupe, përcaktojnë se në cilin medium mund të jenë publikuar dhe shpjegojnë se përse mendojnë ashtu (bie fjala, rrëfime mund të gjejnë nëpër libra, libra me ilustrime, nëpër filma si versione të ekranizuara, po edhe në internet; muzikë mund të dëgjojnë në radio, por edhe në internet e në telefona celularë; reklama mund të shohin në revista, në televizion, po edhe nëpër vitrinat e dyqaneve). Gjatë një bisede të hapur zbulohen përgjigjet e sakta dhe arsyetimet për to.</li> <li>• Me një prezantim video mësimdhënësi paraqet së paku 9 shembuj nga tri lloje të mesazheve të shkurtra mediatike: për të njoftuar për një ngjarje, për të reklamuar ngjarjen dhe për të dhënë udhëzime rreth sjelljes gjatë ngjarjes. Nxënësit, të ndarë në grupe, nxjerrin informacionet e rëndësishme nga çdo mesazh dhe në bazë të tyre i kategorizojnë mesazhet sipas llojit. Gjatë diskutimit zbulohen dallimet në përmbajtjen e mesazheve që përcaktojnë llojin e mesazhit.</li> <li>• Nxënësve të ndarë në dy grupe u jepet nga një temë hulumtimi (p.sh. <i>Ndërtesa</i> dhe <i>Autobusi</i>). Nxënësit mbledhin sa më shumë shembuj mediumesh të ndryshme (ilustrime, fotografi, vizatime, ndonjë vjershëz për autobusin, ndonjë regjistrim audio për uturimën e autobusit, profesione që kanë të bëjnë me autobusin dhe ndërtesën, llojet e ndërtesave e të autobusëve etj.) që lidhen me temën e hulumtimit. Pastaj nxënësit e secilit grup sqarojnë se si e kanë bërë zgjedhjen e përmbajtjeve mediatike. Në fund ata diskutojnë së bashku se cila nga përmbajtjet jep më shumë ndihmesë për t'u kuptuar tema përkatëse.</li> <li>• Nxënësve të ndarë në grupe u jepen përmbajtje të ndryshme mediatike tekstuale të shkruara me shkronja me madhësi, me trashësi dhe me ngjyra të ndryshme. Secilit grup i jepet detyrë që të zbulojë mesazhet kryesore në përmbajtjet "e tyre". Pas përfundimit të detyrës, i paraqesin përmbajtjet dhe mesazhet para të tjerëve. Gjatë diskutimit konstatojnë se si madhësia, trashësia dhe ngjyra e shkronjave ndihmojnë për dërgimin e mesazhit kryesor.</li> <li>• Nxënësve të ndarë në grupe u jepen përmbajtje të ndryshme mediatike me ilustrime me ngjyra. Secilit grup i jepet detyrë që të zbulojë mesazhet kryesore në përmbajtjet "e tyre". Pas përfundimit të detyrës, i paraqesin përmbajtjet dhe mesazhet para të tjerëve. Gjatë</li> </ul>	

diskutimit konstatojnë se si madhësia, pozicioni dhe ngjyra e objekteve të paraqitura ndihmojnë në dërgimin e mesazhit kryesor.

- Me një prezantim video, mësimdhënësi paraqet shembuj të ikonave digjitale (emotikon-e, gif-e dhe meme) që shfrytëzohen në aplikacionet e ndryshme celulare dhe kompjuterike. Nxënësit konstatojnë rëndësinë e tyre duke iu përgjigjur pyetjeve me përgjigjet e ofruara. Nxënësit që u përgjigjen saktë pyetjeve për një ikonë digjitale të dhënë, shpjegojnë edhe kuptimin e saj dhe më pas të gjithë së bashku diskutojnë se ku dhe për çfarë mund të përdoret ajo ikonë.
- Nxënësit të ndarë në grupe mendojnë fjalë ose shprehje çelës për të krijuar një mesazh reklame për ndonjë prodhim sipas zgjedhjes së tyre të lirë (ushqim, pije, lodër, libër, video-lojë) dhe e paraqesin në mënyrë figurative (me vizatim, ilustrim, foto të prera etj.). Atë që kanë menduar ua prezantojnë të tjerëve.
- Nxënësit të ndarë në grupe mendojnë fjalë ose shprehje çelës dhe zgjedhin ilustrime adekuate ose ikona digjitale për një reklamë në pllakat / tabelë lajmërimesh ose në fletëpalosje.
- Nxënësit punojnë në grupe për të krijuar mesazhe mediatike. Secili grup përpilon nga tri mesazhe (njoftim, reklamë dhe udhëzim), kurse secili prej tyre është i destinuar për medium të ndryshëm (revistë, radio, televizion, tabelë lajmërimesh, pllakat, fletëpalosje, internet, telefon celular). Në fund bëjnë prezantimin e mesazheve para të gjithë nxënësve.

## **GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR**

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirjen nëpërmjet kyçjes së të gjithë nxënësve në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënësve dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, mësues vullnetarë dhe profesionistë nga shkolla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi trajton njëlloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipa gjinorë. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi përpiqet të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxitin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave/përmbajtjeve/koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlidhin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

## VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ua mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimitdhënësi i ndjek vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimitdhënies dhe gjatë të nxënësve duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informacione prapavepruese të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe japin udhëzime për përmirësim (vlerësimi formativ). Për këtë qëllim, mësimitdhënësi përcjell dhe vlerëson:

- punimet e nxënësve (krijime, deklarata etj.);
- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimitdhënësi ose nga nxënësit e tjerë;
- përgjigjet e dhëna në fletëzat e punës;
- realizimet praktike (të lexuarit, të shkruarit);
- detyrat e shtëpisë;
- përgjigjet në kontrolle dijesh (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimitdhënies.

Vlerësimi sumativ kryhet në bazë të të dhënave të përgjithshme të përfituara nga përcjellja e arritjeve të nxënësit dhe nga vlerësimi formativ, duke përdorur teknika të ndryshme të vlerësimit formativ, ku mësimitdhënësi konstaton (përshkruan) shkallën e zhvillimit dhe të të arriturave për çdo nxënës veçmas, në kuadër të secilës fushë programore. Në fund të vitit shkollor nxënësi merr notën sumative përshkruese.

<b>Fillimi i zbatimit të programit mësimor</b>	2022/2023
<b>Institucioni/bartës i programit</b>	Биро за развој на образованието Byroja e zhvillimit të arsimit
<b>Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/19 dhe 229/20), ministrja e Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe</i> për klasën II.</b>	

**Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19 и 229/20) министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по *Албански јазик* за II одделение.**

Решение бр. 08-17334/2

17.12.2021 година